LIGJ
Nr.7632, datë 4.11.1992

PËR DISPOZITAT QË RREGULLOJNË PJESËN E PARË TË KODIT TREGTAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Ligjet që zbatohen në fushën e tregtisë

Në fushën e tregtisë zbatohet legjislacioni tregtar. Për çështjet që nuk trajtohen nga ky legjislacion, zbatohen praktikat tregtare; praktikat lokale ose të veçanta marrin përparësi ndaj praktikave të përgjithshme. Në mungesë të tyre zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

Neni 2
Përkufizimi i tregtarit

Konsiderohen tregtarë personat fizikë dhe shoqëritë tregtarë, që gjatë ushtrimit të profesionit kryejnë veprime tregtare në emër të tyre. Ortakët e shoqërive tregtare nuk konsiderohen tregtarë.

Neni 3
Përkufizimi i veprimeve tregtare

Konsiderohen veprime tregtare veçanërisht:

1. Blerja me qëllim rishitjeje, shitja që rrjedh nga një blerje e mëparshme e bërë me qëllim rishitjeje, si dhe përgjithësisht çdo veprim shkëmbimi i lidhur me një veprim tjetër shkëmbimi.
2. Çdo akt i sipërmarrjeve industriale të ndërtimit, të shfrytëzimit të minierave të transportit, të sigurimeve, të magazinimit, të shfaqjeve publike, të reklamës, të botimit e të shtypshkrimit joartizanal;
3. Çdo operacion bankar dhe këmbimi;
4. Të gjitha opreacionet ndërmjetëse tregtare, si operacionet e ndërmjetësisë ose spedicionit dhe ato të përfaqësuesve tregtarë.

Neni 4
Veprimet e tregtarit

Prezumohen tregtarë veprimet e tregtarit, me përjashtim të atyre veprimeve që nuk kanë të bëjnë me tregtinë.

Neni 5
Veprimi tregtar për të paktën njërën prej palëve

Veprimi, edhe sikur të mos jetë veprim tregtar për të gjitha palët, rregullohet nga legjilacioni tregtar, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat e tjera ligjore.

Neni 6
Bujqësia

Veprimet që kanë të bëjnë me aktivitetin bujqësor, nuk janë tregtare, me përjashtim të rasteve kur ato kryhen si sipërmarrje përpunimi ose shitjeje prodhimesh.

Neni 7
Artizanët dhe tregtarët e vegjël

Personat që ushtrojnë të vetëm një veprimtari ekonomike industriale a tregtare, e cila nuk kalon kufijtë e zanatit ose të tregtisë së vogël, si shitësit ambulant, shitësit e vegjël që blejnë e shesin brenda ditës, karrocierët, shoferi i një mjeti privat, si dhe ata që ushtrojnë veprimtari të tjera ekonomike e trEgtare në përmasa të tilla, nuk konsiderohen tregtarë.

Neni 8
Shteti dhe entet publike

Shteti, organet e pushtetit lokal dhe entet e tjera publike nuk marrin cilësinë e tregtarit edhe sikur të bëjnë veprime tregtare, por kur kryejnë veprime të tilla u nështrohen legjislacionit dhe praktikave tregtare.

KAPITULLI II
EMËRTIMI DHE TRANSFERIMI I NJË VEPRIMTARIE TREGTARE

Neni 9
Emërtimi i një tregtari si person fizik

Emërtimi i një tregtari si person fizik duhet të përmbajë të paktën mbiemrin bashkë me emrin ose inicialet e tij.

Neni 10
Emërtimi që mund të sjellë paqartësi

Nuk duhet të regjistrohen në të njëjtin regjistër emërtime tregtare ose shoqërish tregtare, degësh a përfaqësish të tyre, të cilat mund të sjellin paqartësi me emërtime të tjera të regjistruara më parë, pa i shtuar elemente dalluese.

Neni 11
Transferimi i një emërtimi tregtar

Personi që vazhdon një veprim tregtarë të një personi tjetër, mund të ruajë përdorimin e të njëjtit emërtim, me kusht që të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

Nuk mund të transferohet emërtimi pa u transferuar njëkohësisht edhe veprimtaria tregtare.

Neni 12
Pasojat ligjore të transferimit të një veprimtarie tregtare

Në rast transferimi të një veprimtarie tregtare me anën e një akti ndërmjet personave të gjallë, borxhet dhe kreditë e kësaj veprimtarie i kalojnë titullarit të ri, me përjashtim të ratit ku ka një deklaratë që kufizon ose përjashton këtë kalim, e cila publikohet në regjistrin tregtar.

Përgjegjësia e titullarit të vjetër, për borxhet e veprimtarisë tregtare, vazhdon për një periudhë trevjeçare. Në qoftë se afati i shlyerjes së detyrimit ka përfunduar para datës së regjistrimit të aktit të transferimit në regjistrin tregtar, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, periudha trevjeçare fillon që nga data e këtij regjistrimi. Në qoftë se afati i shlyerjes së detyrimit përfundon pas datës së regjistrimit të sipërpërmendur, atëherë periudha trevjeçare fillon që nga data e përfundimit të këtij afati.

KAPITULLI III
REGJISTRI TREGTAR

Neni 13
Mbajtja e regjistrit

Regjistri tregtar mbahet nga gjykatat. Modalitetet për këtë caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14
Konsultimi dhe kopjet

Çdo person mund të konsultohet me regjistrin pa shpenzime.

Kushdo mund të marrë, përkundrejt pagesës paraprake, kopje të regjistrimit dhe të dokumenteve përkatëse ose një certifikatë negative. Kopjet duhet të vërtetohen si të vlefshme nga sekretaria e gjyqit.

Neni 15
Publikimi

Të dhënat e regjistrit tregtar publikohen nga gjykata në Fletoren Zyrtare dhe të paktën në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore. Të dhënat botohen të plota me përjashtim të rasteve kur ligji përmban dispozita të kundërta.

Njoftimi konsiderohet i bërë në përfundim të ditës kur është publikuar të paktën në dy nga gazetat e parashikuara në paragrafin e mësipërm.

Neni 16
Caktimi i gazetave të autorizuara për publikimin e njoftimeve ligjore

Gazetat e autorizuara për publikimin e njoftimeve ligjore caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17
Forma e kërkesave të regjistrimit, e firmave dhe e provave për transferimin e pasurisë

Firmat që figurojnë në kërkesat për regjistrimin në regjistër dhe firmat që depozitohen në aneksin e regjistrit, duhet të vërtetohen si autentike nga noteri ose nga një institucion tjetër

shtetëror.

Kompetencat e dhëna për të lejuar një kërkesë regjistrimi duhet të ndjekin të njëjtën procedurë.

Personat e një pale që kanë blerë nga një tjetër të drejtat mbi pasurinë, duhet të provojnë cilësinë e tyre nëpërmjet një akti noterial ose një akti të formuluar nga një institucion shtetëror.

Neni 18

Regjistrimi i emërtimit tregtar dhe i firmave

Brenda një muaji nga data e fillimit të veprimtarisë tregtare, tregtari duhet të njoftojë emërtimin e tij dhe të depozitojë firmën e tij origjinale në gjykatën e caktuar për mbajtjen e regjistrit tregtar. Me vendim të Këshillit të Ministrave mund të parashikohet që, në varësi nga shkalla e veprimtarisë ekonomike, tregtari të përjashtohet nga detyrimi për regjistrim.

Neni 19

Regjistrimi i një shoqërie tregtare

Kërkesat e regjistrimit të shoqërive tregtare duhet të bëhen nga të gjithë ortakët e një shoqërie kolektive, nga të gjithë ortakët e "pakufizuar" të një shoqërie komandite, nga të gjithë administratorët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe nga të gjithë anëtarët e drejtorisë të një shoqërie anonime.

Deklarohen dhe regjistrohen lloji, kohëzgjatja, në qoftë se kjo është e përcaktuar, emërtimi tregtar, selia, objekti i shoqërisë, shuma e kapitalit themeltar, data e firmosjes së statutit të shoqërisë, si dhe:

1. Për një shoqëri kolektive: emrat, mbiemrat, datëlindjet dhe vendlindjet e ortakëve dhe dispozitat e statutit që përcaktojnë kompetencat e përfaqësimit të administratorëve;

2. Për një shoqëri komandite: të dhënat e parashikuara në pikën 1 dhe cilësia si ortak "i kufizuar", si dhe shuma e kontributeve të ortakëve "të kufizuar";

3. Për një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar: emrat, mbiemrat, datëlindjet dhe vendlindjet e administratorëve, si dhe dispozitat e statutit që caktojnë kompentencat e përfaqësimit të administratorëve;

4. Për një shoqëri anonime: emrat, mbiemrat, datëlindjet dhe vendlindjet e anëtarëve të drejtorisë, si dispozitat e statutit që caktojnë kompetencat e përfaqësimit të anëtarëve të drejtorisë.

I bashkëngjiten kërkesës dhe depozitohen në aneksin e regjistrit statuti, firma dhe akti i emërimit të administratorëve ose të anëtarëve të drejtorisë, një listë që përmban emrat, mbiemrat, datëlindjet dhe vendlindjet e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, si dhe, në rastin e kontributeve në natyrë, raporti për kontributet ose po qe e nevojshme, vendimi i ortakëve për të mos kërkuar ndihmën e ekspertit për kontributet.

Kërkesat për regjistrim shoqërohen, në rastin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe të shoqërive anonime, edhe me certifikatën e depozituesit të fondeve që rezultojnë nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar, ose nënshkrimi i aksioneve për kontributin në para.

Kur ushtrimi i veprimtarive të parashikuara në objektin e shoqërisë kërkon një autorizim zyrtar, kërkesa shoqërohet edhe nga një kopje e vërtetuar e autorizimit.

Shoqëria regjistrohet kur statuti i saj është në përputhje me ligjin dhe kur të gjitha dokumentet e kërkuara nga ligji janë të plotësuara.

Neni 20

Akte që i përkasin subjektit tregtar të regjistruar

Tregtari duhet të njoftojë aktet e dhurimeve të shitjeve, të qirave, të pengjeve, të pushimit ose të likuidimit të tregtisë.

Njoftimi është i detyrueshëm edhe për blerësin, qiramarrësin dhe kreditorin sekuestrues.

Neni 21
Ndryshime dhe anulime

Dispozitat që lidhen me regjistrimin janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet e regjistrimeve të mëparshme. Kërkesat për ndryshime në regjistrim të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe të shoqërive anonime bëhen nga administratorët nga anëtarët e drejtorisë që kanë kompetenca për ta përfaqësuar shoqërinë ndaj të tretëve.

Neni 22
Degët dhe përfaqësitë e tregtarëve të huaj

Dispozitat e këtij kapitulli zbatohen si për tregtarët shqiptar, ashtu dhe për të huajt që çelin një degë ose një përfaqësi në Shqipëri.

Neni 23
Pasojat e regjistrimit

Kur një person është regjistruar në regjistrin tregtar, ai duhet të respektohet prej atij që pretendon që ky person nuk ka cilësinë e tregtarit.

Neni 24
Pasojat ndaj të tretëve

Çdo fakt që duhet të shënohet në regjistrin tregtar, mund t'i kundërshtohet një të treti nga ana e të interesuarit, vetëm në rast se ky fakt është i regjistruar në regjistër dhe i publikuar, ose kur i interesuari sjell prova se i treti kishte dijeni për këtë.

Me përjashtim të rasteve kur vjen në kundërshtim me dispozitat e tjera ligjore, fakti t'i kundërshtohet të tretit, në rast se ai është i regjistruar dhe i publikuar. Fakti nuk mund të kundërshtohet në rast se veprimi në fjalë ka ndodhur brenda 15 ditëve nga data e publikimit dhe në rast se i treti sjell provën që nuk kishte dijeni për këtë fakt dhe që nuk mund të merrte dijeni, duke kryer të gjitha përkujdesjet e zakonshme.

Në rastin kur një fakt që duhet të shënohet në regjistër është publikuar në mënyrë të pasaktë, ky fakt mund t'i kundërshtohet të interesuarit nga ana e një të treti, ashtu siç është publikuar, po qe se i interesuari nuk provon se i treti kishte dijeni për pasaktësinë.

Neni 25
Masat e marra nga gjykata për të siguruar përmbushjen e detyrimeve lidhur me regjistrin

Në rastin kur një person nuk përmbush detyrimin për të kërkuar një regjistrim në regjistrin tregtar ose për të depozituar në aneksin e regjistrit firmën ose një dokument, ai detyrohet nga gjykata ta kryejë këtë veprim me kërkesën e palës së interesuar.

Cilido që nuk zbaton një vendim gjyqësor të formës së prerë, në bazë të paragrafit të mësipërm, dënohet me gjobë nga 2000 deri në 50 000 lekë.

Në rastin kur fshirja e një personi nga regjistri tregtar është pranuar dhe për këtë asnjë palë nuk është i drejtuar gjykatës, fshirja regjistrohet detyrimisht nga gjykata.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.360, datë 21.11.1992, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.